



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. 10188/7443 (31004-04009-86-2015) Rregj.Them.
Data Regjistrimi 01.10.2015

Nr. (86-2016-737)3467 Vendimi
Datë 26.10.2016

V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata Administrative e Apelit, e përbërë prej :

GJYQTAR - Kastriot SELITA

GJYQTAR - Altina NASUFI

GJYQTAR - Bernina KONDI

Asistuar nga sekretare gjyqësore Valbona Zenelaj, në Tiranë, sot më datë 26.10.2016, shqyrtoi në dhomë këshillimi çështjen administrative me palë:

PADITËS: Arben Qato i biri i Sadik dhe i Pranverës i datëlindjes 11.12.1967 me adresë të tij Universal Engineering 08, Godinë Private pranë Benilvës, Rrashbull, Durrës.

I PADITUR: Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Bashkia Durrës.
Bashkia Durrës

Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore Durrës ka deleguar të drejtën e përfaqësimit dhe të mbrojtjes palës së paditur.

OBJEKTI: Shfuqizimin e vendimit nr. 57, datë 29.07.2014 të Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Bashkia Durrës për gjobitjen në kundërshtim me ligjin.

BAZA LIGJORE: Neni 32 i Kodit të Procedurës Civil, ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, Neni 7, 15, 35 e në vijim ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, ligji nr. 9780, datë 19.07.2007 “ Për inspektimin e ndërtimit”.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, me vendimin nr. 179, datë 13.02.2015

ka vendosur :

1. *“Pranimin e kërkesë-padisë.*
2. *Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 57, datë 29.07.2014 të Inspektoriatit Ndërtimor e Urbanistik Bashkia Durrës për caktimin e gjobës në ngarkim të paditësit Arben Qato.*
3. *Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur”.*

Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, ka paraqitur ankimi pala e paditur në datën 25.02.2015.

Pala e paditur në ankimin e paraqitur prej saj ka kundërshtuar vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës duke parashtruar se:

1. Shkresa Nr. 4503 Prot. Date 22.07.2014 nuk është mbajtur nga inspektorët e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Bashkia Durrës, por është shkresa që Bashkia Durrës kërkon marrjen e masave INUV në zbatim të rekomandimeve të KLSH-se.
2. Vendimi i gjobës është tërësisht i mbështetur në ligj dhe në prova.
3. Në rekomandimet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit është pasqyruar me se miri kundërvajtja e kryer si dhe dëmi ekonomik që i është shkaktuar Bashkisë Durrës, gjithashtu në vendimin e dënimit me gjobë se është pasqyruar me se miri baza ligjore si dhe kundërvajtja e kryer. Mos kontrolli punimeve në zbatim të “Rikonstruksion i Bulevardit Kryesor Dyrrah” nga mbikëqyrësi i punimeve, për të cilin paditësi pretendon se nuk është përcaktuar në mënyrë konkrete shkeljet e kryera nga ana e z. Arben Qato.
4. Për sa i përket referimeve të bëra nga paditësi pasi janë shkelur nenet 12, 13 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit” të ndryshuar sqarojmë se nenet e sipërcituara janë nene të shfuqizuara me Ligjin Nr. 23/2013.

Sa sipër pala e paditur kërkon ndryshimin e vendimit Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës dhe rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj e në prova.

Gjykata Administrative e Apelit, pasi e shqyrtoi çështjen në dhomë këshillimi, dëgjoi relacionin e përgatitur nga gjyqtari relator, si dhe analizoi shkaqet e ngritura në ankimet e paraqitura, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 49/2012, në këndvështrim me kërkesat e ligjit material dhe procedural,

VËREN

Pala paditëse Arben Qato i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës me kërkesë padi duke kërkuar:

Shfuqizimin e vendimit nr. 57, datë 29.07.2014 të Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Bashkia Durrës për gjobitjen në kundërshtim me ligjin.

Pala paditëse në lidhje me këto kërtime ka referua si bazë ligjore në Neni 32 i Kodit të Procedurës Civile, ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, Neni 7, 15, 35 e në vijim ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, ligji nr. 9780, datë 19.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes me vendimin nr. 179, datë 13.02.2015, ka vendosur pranimin e padisë së palës paditëse.

Kundër këtij vendimi ka bërë ankimi pala e e paditur për shkaqet e përshkruara në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

Konstatohet se ankimi i paraqitur nga pala e paditur është përcjellë në Gjykatën Administrative të Apelit, duke u verifikuar kushtet e pranueshmërisë së tij, e për rrjedhojë, janë shoqëruar me vendimin e gjyqtarit që ka pranuar ankimin.

Në këto rrethana gjykata e shqyrtoi çështjen administrative të paraqitur nëpërmjet këtyre ankimeve në dhomë këshillimi sipas përcaktimeve të nenit 49/1 të ligjit nr. 49/2012.

Rrethanat e çështjes

Nga aktet e dosjes gjyqësore të përcjella me ankimin kundër vendimit nr. 179, datë 12.03.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës rezulton se:

Në këto kushte paditësi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës në datën 01.10.2014.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës me vendimin nr. 179, datë 13.02.2015 ka vendosur pranimin e padisë së palës paditëse.

Nga përmbajtja e vendimit nr. 179, datë 13.02.2015 të Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Durrës rezulton se gjykata e shkallës së parë ka arritur në këtë zgjidhje me arsyetimin e mëposhtëm:

1. Akti administrativ objekt kundërshtimi nuk jep asnjë të dhënë se cila është shkelja/kundërvajtja administrative e kryer dhe në ç'mënyrë është kryer ajo, duke gjetur të drejtë pretendimin e palës së paditur lidhur me faktin që nuk ka një akt apo procesverbal të mbajtur prej INUK Bashkia Durrës që të evidentojë mangësitë, moskryerjen në mënyrën e duhur të detyrave nga ana e paditësit.
2. Kur flasim për shkelje/kundërvajtje kuptojmë kryerjen e veprimeve ose mosveprimeve të kundërligjshme shoqërisht të rrezikshme të kryera me faj në shkelje të dispozitave ligjore apo nën ligjore sipas përcaktimit të bërë në ligjin nr. 1023/2010.
3. Referuar aktit të Kontrollit të Lartë të Shtetit kundërvajtja administrative e kryer prej paditësit konsiston apo është e lidhur me marrjen e masave për arkëtimin në rrugë ligjore të vlerës prej 7.077.355 lekë nga operatori ekonomik "Eurondërtim 2000" sh.p.k e cila përfaqëson pagesa të përfituara për punë të pakryer në tenderin me objekt "Rikonstruksion i bulevardit kryesor Dyrrah, dhe përgjegjës për të tillë shkelje të gjetur raporti bën fajtor mbikëqyrësin e punimeve Arben Qato. Pra shkelja e pretenduar se është kryer nga paditësi është e lidhur me faktin se nga ana e shoqërisë "Eurondërtim 2000" sh.p.k ka punime të pakryera.
4. Nga ana e palës së paditur nuk është sjellë asnjë provë që të vërtetojë atë që është konstatuar nga ana KLSH në lidhje me punime të pakryera nga ana e shoqërisë ndërtimore Euro Ndërtim, dëm me të cilin është parë i lidhur shkelja e kryer nga ana e paditësit ndaj të cilit është vendosur dënim me gjobë. Kuptohet që e tillë provë do të ishte një vendim gjyqësor i formës së prerë, i cili do të vërtetonte ose

rrëzonte këtë detyrim të “Euro Ndërtim” sh.p.k që sipas raportit të KLSH ekziston kundrejt Bashkisë Elbasan, dhe përcaktonte detyrimin përkatës dhe më pas mund të diskutohej për shkelje të paditësit në mbikëqyrjen e punimeve të kryera nga kjo shoqëri. Në të kundërt Bashkia Durrës ka marrë në dorëzim punën e kryer nga kjo shoqëri me të cilin ka kontraktuar dhe njëkohësisht ka shpërblyer dhe paditësin referuar kontratës së lidhur me shoqërinë mbikëqyrëse administrator i të cilës ai është.

5. Për sa kohë që nuk provohet sa më sipër gjykata nuk e gjen të drejtë vendimin e palës së paditur për të caktuar gjobë ndaj paditësit për kundërvajtjen administrative të kryer, duke mos u evidentuar dhe aq më pak provuar ndonjë shkelje administrative e kryer nga ana e paditësit.

Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, ka paraqitur ankimi pala e paditur në datën 25.02.2015.

Gjykata Administrative e Apelit i shqyrtoi ankimet në dhomë këshillimi duke analizuar tërësinë e rrethanave faktike në referim të përcaktimeve të ligjit të zbatueshëm në rastin konkret.

Vlerësimi i gjykatës

Në analizë të ankimit dhe shkaqeve të ngritura nëpërmjet tij, akteve të dosjes së gjykimit, si dhe të vendimit objekt ankimi, Gjykata Administrative e Apelit çmon se vendimi nr. 179, datë 13.02.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës është rrjedhim i një procesi të zhvilluar në respektim të dispozitave të ligjit procedural. Nga ana tjetër Gjykata e Shkallës së Parë ka gabuar në zbatimin e ligjit material që gjen zbatim në rastin objekt gjykimi e për rrjedhojë ky vendim duhet të ndryshohet dhe padia e paditësit Arben Qato duhet të rrëzohet si e pabazuar në ligj e në prova.

Së pari, Në ankim pala e paditur ka pretenduar se vendimi i gjobës për paditësin është tërësisht i mbështetur në ligj dhe në prova.

Rezulton se paditësi Arben Qato ka patur një marrëdhënie juridike me palën e paditur si mbikëqyrës i punimeve në “Rikonstruksion i bulevardit kryesor Dyrrah”. Kontrolli i Lartë i Shtetit në kontrollin e ushtruar pranë palës së paditur e cila ka arritur në përfundimin se në objektin e prokuruar mes palëve ndërgjyqëse ka patur mangësi të cilat janë referuar me shkresën nr. 1016/27 Prot., datë 30.06.2014, si dhe i janë rekomanduar Kryeinspektorit të Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik të Bashkisë Durrës të vendosë masën 500.000 lekë gjobë ndaj mbikëqyrësit të punimeve; z. Arben Qato pasi nga kontrolli i punimeve me pasojë shkaktimin e dëmit ekonomik Bashkisë Durrës në vlerën 7.077.355 lekë.

Neni 15 i ligjit 8402, datë 10.09.1998 përcakton :

“Shkeljet e neneve 4,5,6,7 e 8 të këtij ligji, kur nuk përbëjnë veprë penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me dënim kryesor, gjobë nga 50,000 deri në 2,000,000 lekë”.

Në pikën 4 të kësaj dispozite përcaktohet se:

“Gjobat vendosen nga Inspektorati Ndërtimor Urbanistik i Bashkisë/Komunës/Qarkut, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin për Inspektimin”.

Në referim të kësaj dispozite, të akteve të dosjes së gjykimit mbikëqyrësi i punimeve është i

detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Gjithashtu mbikqyrësi është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumentave dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.

Gjykata e shkallës së parë ka gabuar në argumentimin e saj se akti administrativ objekt kundërshtimi nuk jep asnjë të dhënë se cila është shkelja/kundërvajtja administrative e kryer dhe në ç'mënyrë është kryer ajo, duke gjetur të drejtë pretendimin e palës së paditëse lidhur me faktin që nuk ka një akt apo procesverbal të mbajtur prej INUK Bashkia Durrës që të evidentojë mangësitë, moskryerjen në mënyrën e duhur të detyrave nga ana e paditësit, si dhe shkelja e pretenduar se është kryer nga paditësi është e lidhur me faktin se nga ana e shoqërisë "Eurondërtim 2000" sh.p.k ka punime të pakryera.

Një vlerësim i tillë i bërë nga gjykata e shkallës së parë është i pabazuar në rrethanat e faktit që rezultojnë të vërtetuara në rastin konkret e për rrjedhojë edhe në përcaktimet e ligjit.

Së dyti: Në lidhje me procedurën e ndjekur nga pala e paditur në lidhje me marrjen e masës administrative vendimit "Për dënim me gjobë" nr. 57, datë 29.07.2014 të Kryeinspektorit, Gjykata Administrative e Apelit çmon se pala e paditur e ka zbatuar procedurën e vendosjes së gjobës në përputhje me ligjin nr. 8402 datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar" si dhe ligjin nr. 9780 datë 16.07.2007 "Për inspektimin e ndërtimit". Gjykata Administrative e Apelit çmon se në rastin objekt gjykimi aktet administrative janë marrë sipas përcaktimeve të nenit 15 të ligjit nr.8402 datë 10.09.1998 që përcakton se:

"Gjobat vendosen nga Inspektoriati Ndërtimor Urbanistik i Bashkisë/Komunës/Qarkut, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin për Inspektimin".

Gjykata e Shkallës së Parë në mënyrë të gabuar ka vlerësuar se nuk e gjen të drejtë vendimin e palës së paditur për të caktuar gjobë ndaj paditësit për kundërvajtjen administrative të kryer, duke mos u evidentuar dhe aq më pak provuar ndonjë shkelje administrative e kryer nga ana e paditësit. Rezulton që sipas Kontratës mbikqyrje punimesh për objektin "Rikonstruksion Bulevardit Kryesor Dyrrah" me nr. 3021 Prot, darë 21.07.2011 lidhur me palëve Autoriteti Kontraktor Bashkia Durrës dhe mbikqyrës punimesh shoqëria "Universal Engineering 08", për këtë të fundit ka nënshkruar vet paditësi Arben Qato.

Në përmbajtje të kontratës pika 25 e saj përcakton se :

"Mbikqyrësi i punimeve gjatë gjithë veprimtarisë duhet të zbatojë të gjitha dispozitat e parashikuara në këtë kontratë si dhe kërkesat e detyrimit që rrjedhin nga ligji 8402, datë 10.09.1998 të ligjit, si dhe të udhëzimit nr. 3 datë 15.02.2001 dhe udhëzimit nr. 4, datë 17.05.2001 "Për mbikqyrjen e punimevetë ndërtimit", si dhe mban përgjegjësi sipas dispozitave ligjore në fuqi për mosrespektimin e tyre. Për pasojë pala paditëse ka shkelur detyrimet kontraktore e për pasojë mban përgjegjësi ligjore.

Gjykata Administrative e Apelit çmon se në kundërshtim me sa ka argumentuar Gjykata e Shkallës së Parë, pala e paditur ka respektuar procedurën e përcaktuar nga ligji nr. 8402 datë 10.09.1998. Për pasojë, vendimi për dënim me gjobë nr. 57, datë 29.07.2014 i palës së paditur Inspektoriati Ndërtimor Urbanistik Bashkia Durrës përmban bazën ligjore ku

mbështetet ky akt, si dhe shpjegimin në lidhje me faktet dhe provat që provojnë pala paditëse ka kryer kundravajtje administrative mos kontroll i punimeve në zbatim të rikonstruksionit të Bulevardit Kryesor Dyrrah. Në këto rrethana, në kushte në të cilat rezulton se akti administrativ objekt kundërshtimi nga pala paditëse është nxjerrë në përputhje të plotë me rrethanat faktike të vërtetuara si dhe me përcaktimet e ligjit që rregullojnë këtë situatë faktike, Gjykata Administrative e Apelit e gjen padinë e ngritur nga pala paditëse të pabazuar në prova dhe në ligj dhe si e tillë ajo duhet të rrëzohet. Në analizë të sa më sipër, Gjykata Administrative e Apelit çmon se pretendimet e ngritura në ankim nga pala e paditur janë të bazuara në rrethanat e faktit si dhe në përcaktimet e ligjit e si të tilla këto pretendime duhet të pranohen.

Në rrethanat e përshkruara sa më sipër Gjykata Administrative e Apelit bazuar në nenin 50 gërma "c" të ligjit Nr. 49/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", vlerëson se vendimi nr. 179 datë 13.02.2015, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës duhet të ndryshohet dhe padia e palës paditëse, të rrëzohet si e pabazuar në ligj e në prova.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, bazuar në nenin 50 gërma "c" të ligjit nr. 49, datë 03.05.2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*",

VENDOSI :

1. Ndryshim e vendimit nr. 179, datë 13.02.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.
2. Rrëzimin e padisë si të pambështetur në ligj e prova.
3. Shpenzime gjyqësore nuk ka.
4. Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë brenda 30 ditëve duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

U shpall në Tiranë sot më datë 26.10.2016

GJYQATAR
Bernina KONDI

GJYQATAR
Altina NASUFI

GJYQATAR
Kastriot SELITA

SEKRETARE
Valbona ZENELAJ